



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 3111 Prot

MINISTRI

Tiranë më 20.7 2022

UDHËZIM

Nr. 458 datë 26.7 2022

"PËR  
PROCEDURËN E HEDHJES SË TË DHËNAVE DHE DOKUMENTACIONIT NË  
ARKIVËN E REGJISTRIT ELEKTRONIK KOMBËTAR TË AFTËSISË SË  
KUFIZUAR"

Në mbështetje të nenit 102, pikë 4 të Kushtetutës, të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në republikën e shqipërisë", të pikës 16 të Vendimit nr. 277 datë 18.6.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit" të ndryshuar, dhe pikës 6 të Vendimit nr. 869, datë 18.06.2008, "Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Statusi i invalidit" të ndryshuar dhe të Vendimit nr. 182, datë 26.2.2020 "Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfilimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmësit personal" të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Të dhënat dhe dokumentacioni i përfunduar ekzistues të pagesave të aftësisë së kufizuar bëhet pjesë e arkivës elektronike të Regjistrit Elektronik Kombëtar.
2. Plotësimi i arkivës elektronike me të dhënat dhe dokumentacionin e dosjeve të pajedhura më parë apo të papërditësuara për personat me aftësi të kufizuara fizike, mendore, paraplegjikët, tetraplegjikët dhe të verbët, bëhet nga strukturat përgjegjëse të Shërbimit Social Shtetëror, brenda një afati 2-mujor nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.
3. Hedhja dhe përditësimi i dokumentacionit të dosjeve për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, për paraplegjikët, tetraplegjikët dhe të verbët, realizohet nga strukturat përgjegjëse të Shërbimit Social Shtetëror brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e dosjeve nga KMCAP/KMPV. Ky dokumentacion përfshin:
  - a) çdo fletëdrejtimi që përmban dosja;
  - b) epikrizën e komisionimit;

- c) vendimin e KMCAP/KMPV niveli i parë (përfshirë argumentimin e vendimit me
- d) arsyet e divergjencës);
- e) vendimin e KMCAP Epror;
- f) çertifikatën e gjendjes familjare;
- g) dokumentin e identifikimit.

4. Dosjet elektronike të përfituesve me status të verbërisë dhe status paraplegji-tetraplegji, përmbajnë çdo fletëdrejtim dhe çdo epikrizë të dosjes fizike.

5. Hedhja e dokumentacionit nga strukturat përgjegjëse të Shërbimit Social Shtetëror shoqërohet edhe me përditësimin e të dhënave të mëposhme:

- a) tipi i dokumentit;
- b) numri i vendimit;
- c) vlefshmëria e afateve të përfitimit;
- d) të dhëna të tjera mbi lëndën dhe përshkrimin.

6. Për çdo përfitues reaktohet diagnoza dhe kategoria e aftësisë së kufizuar në të cilën përfshihet kjo diagnozë.

7. Hedhja dhe përditësimi i të dhënave të përfituesve të pagesave të aftësisë së kufizuar, ndihmësve personalë të personave me aftësi të kufizuara dhe të gjitha kompensimet dhe kompensimet e tjera bëhen nga administratori shoqëror i njësisë administrative. Këto të dhëna përfshijnë:

- a) numrin personal të dokumentit të identifikimit të ndihmësit personal;
- b) pagesën mujore të personit me aftësi të kufizuar fizike, mendore/paraplegjikut, tetraplegjikut/ë verbërit;
- c) të gjitha kompensimet si energjinë elektrike, telefoninë;
- d) pagesat për ndjekjen e arsimit;
- e) përfitimin e paketës higjieno-sanitare.

8. Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror marrin zvarishtë në dorëzim nga KMCAP/KMPV dosjet e vlerësuara me apo pa grup për ti hedhur në arkivën elektronike.

9. Dosja elektronike është e barazvlefshme me dosjen fizike, për efekt ekzekutimi pagesash.

10. Institucionet përgjegjëse të përcaktuara në pikat 2.3.5 dhe 7 të këtij Udhëzimi të cilat ngarkohen për hedhjen dhe përditësimin e të dhënave dhe të dokumentacionit të përfitimit të aftësisë së kufizuar, realizojnë hedhjen dhe përditësimin e tyre në arkivën elektronike duke signuar që dokumentacioni, të dhënat dhe çdo lloj përfitimi tjetër për shtak të aftësisë së kufizuar nga

programi i mbrojtjes sociale, është hedhur i përditësuar në arkivën e Regjistrit Elektronik Kombëtar.

11. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal dhe njësitë e vërtetuesjes vendore.

12. Udhëzimi nr. 1, datë 03.02.2017, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletaren Zyrtare.

Ogeria MANASTIRLIU

